



AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

UDHEZUES

**PËR DREJTUESIT DHE MËSUESIT E SHKOLLAVE
PROFESIONALE**

(Në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2016-17)

Tiranë, shtator 2016

UDHËZUES
në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2016-17

Udhëzimet dhe sqarimet e mëposhtme u shërbejnë drejtuesve dhe mësimeve të lëndëve dhe moduleve profesionale të shkollave profesionale, për planifikimin e drejtimeve/profileve profesionale në shkollat e tyre, për analizimin e skeletkurrikulave të drejtimeve/profileve profesionale, për hartimin e programeve mësimore të detajuara (teorike dhe praktike) të nivelit shkollor, si dhe për zbatimin e tyre në procesin mësimor (përfshirë mësimeve dhe vlerësimin e nxënësve).

1. Në lidhje me Nivelet dhe Strukturën e Arsimit Profesional

- Arsimi Profesional (parauniversitar) ofrohet pas arsimit të detyruar 9 vjeçar, me një kohëzgjatje maksimale 4 vjeçare, në tre **Nivele arsimore** (referuar edhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve - KSHK):

- a) Niveli parë (2 vjeçar) – punonjës gjysëm i kualifikuar (Niveli II në KSHK)
- b) Niveli dytë (1 vjeçar) – punonjës i kualifikuar (Niveli III në KSHK)
- c) Niveli tretë (1 vjeçar) – teknik/menaxher si dhe maturë profesionale (Niveli IV në KSHK)

- Shkollat profesionale (me miratim nga MMSR) mund të ofrojnë gjithashtu edhe profile mësimore profesionale të Nivelit të katërt (pas të mesmes) (Niveli V në KSHK), me kohëzgjatje 1 vjeçare).

- Arsimi Profesional ofrohet për **drejtime profesionale** (të gjera) dhe secili drejtim profesional vijon në **profile profesionale** respektive (më të ngushta).

- Këto nivele të drejtimeve/profileve të Arsimit Profesional ofrohen në disa **Struktura** arsimore (shih Aneksin 1):

- a) Struktura **2+1+1** vjeçare. Me këtë strukturë, në Nivelin e parë (2 vjeçar) ofrohen drejtime të gjera profesionale. Në Nivelin e dytë (1 vjeçar), çdo drejtim profesional vijon me disa profile profesionale. Në Nivelin e tretë (1 vjeçar), çdo profil profesional vijon përsëri vetëm në drejtimin profesional përkatës.
- b) Struktura **2+2** vjeçare. Me këtë strukturë, në Nivelin e parë (2 vjeçar) ofrohen drejtime të gjera profesionale. Në Nivelin e tretë (2 vjeçar), që integron edhe Nivelin e dytë, çdo drejtim profesional vijon me disa profile profesionale përkatëse.
- c) Struktura **bllok 4** vjeçare, përfundon me Nivelin e tretë (i ka të integruara edhe Nivelin e parë, edhe Nivelin e dytë) dhe ofrohet në pak drejtime profesionale.

- Nxënësit që përfundojnë me sukses një nivel të caktuar, mund të vijojnë nivelin më të lartë (në të njëjtin drejtim ose në një nga profilet e këtij drejtimi) ose mund ti drejtohen tregut për punës për punësim.

- Nxënësit që përfundojnë me sukses një nivel në një drejtim të caktuar, **nuk mund** të vijojnë nivele më të larta në një drejtim tjetër ose në profile të drejtimeve të tjera.



2. Në lidhje me kurrikulat e Arsimit Profesional

- Dokumenti themelor (kombëtar) i një (drejtimi/profili) profesional që ofrohet në shkollat profesionale publike, është **Skeletkurrikuli** i këtij drejtimi/profili profesional të AP, në një nivel të caktuar.
- Çdo Skeletkurrikul përmban emërtimin e drejtimit, profilit dhe nivelin përkatës (p.sh., Skeletkurrikuli për profilin “Shërbime motorike”, Niveli II i drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”).
- Çdo Skeletkurrikul përmban edhe listën e kompetencave që fitojnë nxënësit, planin mësimor, programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale, përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale, si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për realizimin e shkollimit profesional përkatës.
- Drejtuesit e shkollave profesionale duhet ti njohin mësimdhënësit jo vetëm me programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve që ata do të trajtojnë, por edhe me **skeletkurrikulat e plota** në tërësi.
- Skeletkurrikulat e AP **nuk përmbajnë** programet e lëndëve të kulturës së përgjithshme. Këto programe përgatiten nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe mund të gjenden në faqen e internetit të IZHA (www.izha.edu.al).
- Lista e Skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale që ofrohen në Arsimin Profesional jepet në format tabelar në **Aneksin 1**. Kjo listë ndryshon dhe pasurohet çdo vit shkollor. Në Aneksin 1 tregohen edhe skeletkurrikulat **e reja** dhe skeletkurrikulat që janë **rishikuar** dhe për vitin shkollor 2016-17, ndërsa në **Aneksin 2** detajohen ndryshimet e bëra te ato. Drejtuesit e shkollave profesionale duhet ta studiojnë këtë listë për të shikuar mundësitë e hapjes së drejtimeve/profileve të reja në shkollat e tyre, si dhe për të informuar mësimdhënësit për ndryshimet përkatëse.
- Shkollat profesionale, **bazuar në Skeletkurrikulat** e kualifikimeve profesionale që ofrojnë, hartojnë “**kurrikulat shkollore**” përkatëse, të cilat miratohen nga Drejtori i shkollës, pas pëlqimit të dhënë nga Departamenti profesional përkatës.
- Kurrikula shkollore e çdo kualifikimi profesional përbëhet nga:
 - a) “plani mësimor operativ”, i cili hartohet bazuar në “planin mësimor” që jepet në skeletkurrikulin e kualifikimit profesional përkatës;
 - b) “programet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale”, të cilat hartohen bazuar në “programet e përgjithshme të lëndëve profesionale” përkatëse (të përfshira në skeletkurrikul);
 - c) “programet e mësimdhënies së moduleve praktike profesionale” të cilat hartohen bazuar në “përshkruesit e moduleve profesionale” përkatëse (të përfshira në skeletkurrikul).

3. Në lidhje me përpilimin e “orarit të shkollës” dhe trajtimin e moduleve praktike.

Kur përpilohet orari i shkollës duhet patur parasysh që:

- Për **lëndët teorike profesionale** veprohet njësoj siç veprohet edhe me lëndët teorike të kulturës së përgjithëshme.

- **Modulet praktike profesionale rekomandohet** të realizohen me 3 orë në javë ose me 6 orë (1 ditë) në javë (kohëzgjatja e moduleve profesionale është e plotpjestueshme me 3 ose me 6 orë).
- Trajtimi i moduleve në një klasë mund të bëhet **në vijimësi** (psh, mbaron moduli 1, fillon moduli 2, dhe kështu me rradhë), por mund të trajtohen dhe dy ose më shumë module **paralelisht** (psh, në një javë, 3 orë moduli 1 dhe 3 orë moduli 2, ose një javë moduli 1 me 6 orë, pra një ditë, dhe javën tjetër moduli 2 po me 6 orë).
- Një modul që ka p.sh., 36 orë, mund të trajtohet edhe me 18 orë në periudhën e parë të vitit, dhe me 18 orë në periudhën e dytë, ose, p.sh., 12 orë në tetor dhe 24 orë në dhjetor (psh, në Bujqësi, realizimi i disa moduleve ose RM-ve varet nga stina kur kryhen punime/proces të caktuara).
- Për të shfrytëzuar me efektivitet mjediset e praktikave, një klasë e madhe mund të ndahet në dy grupe nxënësish (nëse lejohet nga pikpamja administrative), të cilat angazhohen në të njëjtën kohë për dy module (ose dy RM) të ndryshme.
- Përzgjedhja e modulit/moduleve me zgjedhje të detyruar (nga lista e moduleve të ofruar në skeletkurrikul) bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar: **(i)** kërkesat e tregut të punës; **(ii)** kërkesat e nxënësve dhe **(iii)** mundësitë e shkollës për ta trajtuar modulën/modulet përkatëse. Klasa të ndryshme mund të përzgjedhin module të ndryshme me zgjedhje, ose një klasë e madhe, mund të ndahet në dy grupe dhe secili grup përzgjedh module të ndryshme. Një nxënës, pasi e ka përzgjedhur dhe ka filluar realizimin e një moduli me zgjedhje, nuk mund ta ndryshojë më atë.
- Pasi shkolla të ketë përcaktuar modulën (modulet) me zgjedhje që do të trajtojë, atëherë ky modul konsiderohet njësoj si modulet e tjera të detyruara.
- Megjithëse në “Planin mësimor” që jepet në skeletkurrikul, rubrika e moduleve me zgjedhje ka 1 ose 2 orë në javë, kjo nuk do të thotë që edhe gjatë realizimit të moduleve me zgjedhje ato duhet të trajtohen çdo javë me nga 1 ose 2 orë. Sikurse theksohet më sipër, pasi përcaktohet moduli (modulet) me zgjedhje, konsiderohet si i detyruar. Çdo modul me zgjedhje do të ketë një total prej 36 (34) apo 54 (51) orësh do të trajtohet njësoj si modulet e detyruara, pra me ndarje 3 ose 6 orëshe (sipas orarit të shkollës).
- Modulet e praktikave profesionale mund të realizohen **të shpërndara gjatë vitit** (me 3, 6, 9 ose 12 orë/javë) siç është sqaruar më sipër, por mund të trajtohen edhe **të grupuara** (p.sh., një ose dy javë rrjesht). Një shkollë mund të planifikojë edhe praktika të grupuara (në ndërmarrje ose në mjediset e praktikave të shkollës). Në këtë rast duhet të bëhen rregullimet e nevojshme në orarin e lëndëve teorike (të përgjithshme dhe profesionale). E rëndësishme është të **zbatohet vëllimi i orëve** të paracaktuara për çdo lëndë/modul në planin mësimor.
- Modulet praktike (ose RM të veçanta të tyre) mund të realizohen në mjediset e praktikave të shkollës ose në biznese/ndërmarrje. Skeletkurrikuli nuk përcakton pjesën e praktikës profesionale si dhe modulet (ose RM-të e tyre) që duhet të realizohen në mjediset praktike të shkollës apo në mjediset e bizneseve/ndërmarrjeve. Është **vetë shkolla** që i përcakton këto nisur nga mundësitë konkrete dhe marrëveshjet me bizneset në rajonin përkatës.



Pra, **shkolla ka pavarësi të plotë** në renditjen dhe orarin e trajtimit të moduleve praktike, sigurisht duke konsideruar dhe faktorë të tjerë si: parimet didaktike, vartësinë logjike të moduleve (p.sh., ka raste kur moduli 5 nuk mund të realizohet pa u përmbushur moduli 2), numrin e klasave, stinën kur do të kryhet praktika, mjediset ku do të realizohen modulet. Për të shfrytëzuar me efektivitet mjediset e praktikave profesionale, mund të realizohen paralelisht module që nuk kërkojnë të njëjtin mjedis praktike (metoda me poste pune, me rotacion).

4. Në lidhje me hartimin dhe zbatimin e “programeve të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale”:

- Në skeletkurrikul jepen programe të **përgjithshme** (sintetike) të lëndëve profesionale, ku **detyruese** (pra, që nuk mund të ndryshohen nga shkolla) janë synimet e lëndëve, temat dhe kohëzgjatjet përkatëse. Mësuesit (duke punuar në grupe) duhet të hartojnë **programe analitike**, pra të detajojnë çdo temë, në elementet përbërëse (nëntemat, orët, objektivat përkatëse etj.). Për këtë mund të përdoret formati i programit (shkollor) të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale, i shpërndarë nga AKAFPK (shih **Aneksin 3**).
- Në programin e detajuar (shkollor) të lëndës, nëntemat (çështjet) e çdo teme duhet të kenë një kohëzgjatje jo më të vogël se 1 orë mësimore, por mund të jenë edhe 2 apo 3 orëshe. Kjo gjë lehtëson si planifikimin e mësimit, ashtu edhe plotësimin e regjistrit nga mësuesi.
- Në rastet kur në skeletkurrikul, ndonjë nga temat e një lënde profesionale ka kohëzgjatje 1 orëshe, atëherë nuk ka vend për detajim të mëtejshëm në nëntema, por ajo merret e mirëqenë ashtu siç është.
- Në programin e detajuar (analitik), në përputhje me natyrën e lëndës profesionale, brenda kohëzgjatjes së temave, duhet të parashikohen edhe orë për provimet, përsëritjet, punët e laboratorit, vizitat mësimore etj., sipas rastit.
- Format i “programit të mësimdhënies së lëndës teorike profesionale” që i është ofruar shkollave nga Agjencia Kombëtare e AFPK është **rekomandues**, pra ai edhe mund të ndryshohet, duke u bërë më shumë ose më pak i detajuar se ai i ofruari. Sidoqoftë, mirë është që të gjithë mësuesit e së njëjtës shkollë të bien dakord dhe të përdorin të njëjtin format.

5. Në lidhje me hartimin dhe zbatimin e “programeve të mësimdhënies së moduleve praktike profesionale”:

- Në skeletkurrikul paraqiten **“përshkruesit e moduleve praktike profesionale”**, ku detyruese janë kohëzgjatja e modulit, Rezultatet Mësimore (RM), instrumentet dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve. Mësuesit e praktikave (duke punuar në grup) duhet që për çdo modul të hartojnë **“programin e mësimdhënies së modulit praktik”**, pra për çdo RM, duhet të detajojnë elementet përbërëse (kohëzgjatjet e RM-së, instrumentet e vlerësimit, veprimtaritë mësimore si dhe kohëzgjatjet e tyre, vendin ku do të realizohen, kërkesat për realizimin etj., për çdo veprimtari). Për këtë mund të përdoret formati i programit të mësimdhënies së modulit, shpërndarë nga AKAFPK (shih **Aneksin 4**).

- Në përshkruesin e modulit, RM-të, instrumentet dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve janë **detyruese** (pra, nuk mund të ndryshohen nga shkolla). Mësuesi i praktikës (shkolla) **ka pavarësi** për të përcaktuar kohëzgjatjen e çdo RM-je si dhe për të detajuar “veprimtaritë mësimore, vendin e realizimit si dhe kërkesat për realizimin” e RM-së përkatëse.
- Rekomandohet që një RM të mos ketë kohëzgjatje më të vogël se 3 orë mësimore, dhe përgjithësisht, kohëzgjatja e tyre të jetë shumfish i 3 orëshit (psh, 3; 6; 9; 12 orë e kështu me rradhë).
- Kur hartohen “veprimtaritë mësimore”, duhet që kohëzgjatja e tyre të mos jetë më e vogël se 1 orë mësimore, por mund të jenë edhe 2 ose 3 orëshe. Kjo gjë lehtëson si planifikimin e mësimit praktik, ashtu edhe plotësimin e regjistrit. Në rast se planifikohen edhe veprimtari mësimore me kohëzgjatje të vogël (psh, 15 ose 20 minutëshe), atëherë mund të bashkohen 2-3 veprimtari të cilat do të kenë kohëzgjatje totale 1 orëshe. Kjo mundëson plotësimin e regjistrave me veprimtaritë mësimore (temat) përkatëse.
- Në “programin e mësimdhënies së modulit”, në përputhje me natyrën e modulit profesional, brenda kohëzgjatjes së RM-ve, mund të parashikohen **veprimtari mësimore** që tregojnë ato çka kryen si mësuesi i praktikës, ashtu edhe nxënësit (p.sh., rikujtim i aspekteve teorike, përgatitje e vendit të punës, demonstrim i një procesi pune nga instruktori, praktikim i mbikqyrur i një procesi pune nga nxënësit, praktikim i pavarur, provim praktik i nxënësve, vizitë mësimore, praktikë shtesë për modulet ose RM-të që nuk janë arritur nga nxënësit e prapambetur etj.).
- Rekomandohet që për çdo modul profesional, të parashikohen disa orë në dispozicion të veprimtarive për mbështetjen e **nxënësve të prapambetur** (që nuk arrijnë të marrin notë kaluese, ose që kanë munguar në RM të caktuara).
- Formatu i “programit të mësimdhënies së modulit”, që i është ofruar shkollave nga Agjencia Kombëtare e AFPK është **rekomandues**, pra ai edhe mund të ndryshohet duke u bërë më shumë ose më pak i detajuar se ai i ofruari. Sidoqoftë, mirë është që të gjithë mësuesit e së njëjtës shkollë të bien dakord dhe të përdorin të njëjtin format.

6. Në lidhje me “vlerësimin e nxënësve”:

- Nxënësit vlerësohen me “**nota**” si në **lëndët** teorike profesionale, ashtu edhe në **modulet** praktike profesionale.
- Në bazë të “**Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar**”, miratuar me Urdhërin e Ministrit, nr. 343, datë, 19.08.2013, të ndryshuara me Urdhërin e Ministrit, nr. 169, datë 08.05.2014, vlerësimi i nxënësve do të jetë:
 1. Në lëndët teorike profesionale, nxënësi, gjatë vitit shkollor vlerësohet:
 - a) për një ose disa orë mësimore të sapozhvilluara (**vlerësim i vazhduar**);
 - b) për një ose disa tema (kapituj) sipas programit lëndor (**vlerësim përmbledhës**).
 2. Nota vjetore e një nxënësi për lëndët teorike profesionale, njehsohet me formulën:

Nota vjetore lëndore = $0,4 \times M1 + 0,6 \times M2$, ku M1, M2 janë përkatësisht mesataret aritmetike të vlerësimeve për pikat 1/a dhe 1/b, të rrumbullakosura me një shifër pas presjes.

3. Në çdo modul praktik profesional, për çdo Rezultat Mësimor (RM), nxënësi vlerësohet gjatë dhe në fund të periudhës që i përket përmbushjes së një RM-je. Nota për modul llogaritet si mesatare e thjeshtë e vlerësimeve për çdo RM.
4. Në fund të realizimit të çdo projekti të nxëni (për drejtimin e Intaluesit Termohidraulik), nxënësi vlerësohet për anën teorike dhe praktike. Nota për një projekt të nxëni llogaritet si mesatare e thjeshtë e vlerësimeve për anën teorike dhe atë praktike.
5. Për praktikën profesionale në industri/biznes, në bashkëpunim me biznesin, nxënësi vlerësohet nga instruktori në fund të realizimit të kësaj praktike.
6. Nxënësi që ka munguar në një prej vlerësimeve të mëposhtme:
 - a) në vlerësimin e një ose disa RM-ve të një moduli;
 - b) në vlerësimin e pjesës teorike ose praktike të një projekti të nxëni, është i detyruar t'i nënshtrohet këtij vlerësimi brenda vitit shkollor.

- Që një modul të konsiderohet i plotësuar nga nxënësi, ai duhet të angazhohet në veprimtaritë e çdo RM-je dhe **të vlerësohet me notë për shkallën e përmbushjes së çdo RM-je**. Këto nota duhet të evidentohen në regjistër. Një nxënës duhet të ketë **të paktën një notë për çdo RM**. Nota përfundimtare e modulit praktik evidentohet në regjistër, ashtu sikurse edhe për lëndët teorike.

- Vlerësimi i nxënësve për modulin praktik mund të jetë vlerësim **i vazhdueshëm** (gjatë kryerjes së veprimtarive praktike) dhe/ose vlerësim **përmbledhës** (në fund të çdo RM-je).

- Nëse një nxënës nuk arrin të marrë notë kaluese në një RM-të caktuar, atij i jepet një shans i dytë për t'u rivlerësuar (pasi të ketë zhvilluar veprimtari praktike shtesë për këtë RM).

- Nëse një nxënës/e (për arsye të ndryshme) nuk ka mundur të marrë pjesë në realizimin e një moduli të caktuar, atëhere shkolla (instruktori përkatës) duhet t'i krijojë mundësi atij/asaj që, në mënyrë të individualizuar, të praktikohet dhe të vlerësohet për këtë modul (në kuadrin e orëve që duhet të planifikohen te çdo modul për praktika shtesë të nxënësve të prapambetur).

- Vlerësimi i kompetencave të nxënësve duhet të bëhet kryesisht nëpërmjet **"listave të kontrollit"**, të cilat verifikojnë arritjet e nxënësve kundrejt **"kritereve të vlerësimit"**. Këto të fundit duhet të merren (kopjohen) nga rubrika përkatëse në çdo RM të modulit dhe mund të pasurohen më tej me specifikime të niveleve të arritjes së nxënësve. Listat e kontrollit mund të jenë individuale (për çdo nxënës) ose kolektive (një listë për të gjithë grupin ose klasën). Në të dyja rastet, kriteret e vlerësimit duhet të jenë të njëjta.

Për sa i takon vlerësimin në provimet përfundimtare të çdo niveli, t'i kushtohet kujdes përdorimit të programeve orientuese të treguara në **faqen e AKAFPK-së**, pasi për një pjesë të tyre ka ndryshime

7. Në lidhje me "plotësimin e regjistrave":



- **Lëndët e teorisë profesionale** plotësohen në regjistër njësoj si lëndët teorike të kulturës së përgjithshme.
- **Modulet** e praktikës profesionale, pavarësisht nga kohëzgjatja, **plotësohen në regjistër në mënyrë të ngjashme me lëndët teorike profesionale**. Çdo modul praktik duhet të ketë faqe të veçantë në regjistër, dhe të plotësohet si për frekuentimin (mungesat), ashtu edhe për notat dhe për temat. Në vend të temave (çështjeve) që shënohen te lëndët teorike, te modulet praktike shënohen “veprimtaritë mësimore” (me kohëzgjatje 1, 2 ose 3 orëshe) të cilat janë planifikuar më parë nga instruktori (te programi i mësimdhënies i modulit) dhe miratuar nga drejtori i shkollës.
- Në lidhje me frekuentimin dhe mungesat e nxënësve te modulet, zbatohen të njëjtat rregulla si dhe për lëndët teorike.

8. Në lidhje me ndryshimet e javëve mësimore.

- Në udhëzimet e ndryshme të lëshuara nga MMSR dhe MAS mund të bëhen ndryshime të herëpashërshme të javëve mësimore në vite të ndryshme të shkollimit në Arsimin Profesional. Këto ndryshime **nuk mund** të pasqyrohen në skeletkurrikulat e hartuara më parë. Në këto raste, mësuesit specialistë të lëndëve dhe praktikave profesionale, duhet të bëjnë vetë llogaritjet e duhura, duke konsideruar ndryshimet në javët mësimore (shtim apo pakësim orësh) dhe t'i pasqyrojnë ato edhe në programet e detajuara të mësimdhënies së lëndëve dhe moduleve profesionale, të cilat i miratojnë në drejtoritë e shkollave profesionale.

9. Në lidhje me ndryshimet në lëndët e kulturës së përgjithshme në Arsimin Profesional.

Në kuadrin e reformimit të kurrikulës bërthamë të arsimit parauniversitar, në zbatim të urdhërit të përbashkët të MAS dhe MMSR, Nr.69, dt. 14.04.2016, “Për rishikimin e planit mësimor të lëndëve të kulturës së përgjithshme të kualifikimeve profesionale të niveleve I-II-III të Arsimit Profesional”, Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), në bashkëpunim me AKAFPK, ka hartuar Planin mësimor dhe programet lëndore (të rishikuara) për të tre strukturat e Arsimit Profesional (2+1+1, 2+2 dhe bllok 4 vjeçar).

Duke filluar nga viti shkollor 2016-17, **vetëm për kl.10**, në të gjitha drejtimet/profilet e Arsimit Profesional, do të fillojë të zbatohet Plani mësimor dhe programet lëndore të kulturës së përgjithshme, të rishikuara. Ndërsa kl.11-12-13 do të vijojnë me planin mësimor dhe programet **e mëparshme** për lëndët e kulturës së përgjithshme. Plani dhe programet e rishikuara do të zbatohen gradualisht edhe në vitet në vijim.

Planin mësimor dhe programet lëndore të kulturës së përgjithshme, të rishikuara për Arsimin Profesional do ti gjeni në faqen e Internetit të IZHA-s, në adresën:

<http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-profesional-kultura-e-pergjithshme/>.

Kini parasysh që në tabelat e rishikuara, jepen të detajuara dhe janë detyruese lëndët e kulturës së përgjithshme, ndërsa ndarjet kohore (orët totale) që jepen për lëndët profesionale dhe modulet profesionale janë

orientuese. Për pjesën profesionale ju do të zbatoni ato ndarje kohore që tregohen në skeletkurrikulat përkatëse, që gjenden në Portalin e AFP ose në faqen e Internetit të AKAFPK.

Në faqen e Internetit të AKAFPK (akafp.gov.al) do të gjeni skeletkurrikulat e rishikuara për të gjitha drejtimet/profilet mësimore të Arsimit Profesional, që do të përmbajnë edhe ndryshimet në planin mësimor të kulturës së përgjithshme, për kl.10 (për vitin shkollor 2016-17).

Kini parasysh që edhe në përzgjedhjen e teksteve mësimore për lëndët e kulturës së përgjithshme të kl.10, do të përdoret Plani mësimor dhe programet e reja (të rishikuara), ndërsa për klasat e tjera (11-12-13), do të përdoren Plani mësimor dhe programet e mëparshme (në të gjitha raste, do të përdoren tekstet bazë që janë hartuar dhe miratuar për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm).

Shënim:

Vetëm drejtimi i “Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” dhe profilet e tij nuk do ta zhvillojnë lëndën e TIK si pjesë e Planit mësimor të kulturës së përgjithshme (çështjet e kësaj lënde trajtohen hollësisht në lëndët/modulet e kulturës profesionale të këtij drejtimi).

10. Udhëzime të tjera:

- Drejtuesit e shkollave profesionale mund të marrin skeletkurrikulat (në format elektronik) në Portalin e AFP (www.vet.al) ose në faqen e Internetit të Agjencisë Kombëtare të AFPK (akafp.gov.al).

- Drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale duhet të kërkojnë periodikisht në **faqen e Internetit** të Agjencisë Kombëtare të AFPK pasi aty mund të marrin: udhëzime dhe sqarime të ndryshme, skeletkurrikulat, përshkrimet e profesioneve, përshkrimet e kualifikimeve profesionale, **materiale mësimore mbështetëse** (për lëndët profesionale), programet orientuese të provimeve teorike dhe praktike, shembuj pyetjesh për testet teorike profesionale, studime, informacione dhe botime të ndryshme për AFP, njoftime për pjesmarrje si bashkëpunëtorë në grupet e punës së AKAFP-së etj.

- Të gjitha skeletkurrikulat, programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve kanë **kode** të veçanta, ku dy numrat e fundit tregojnë vitin e miratimit (p.sh., H-I-11 do të thotë: H – drejtimi Bujqësi; I – Niveli I dhe 11 – miratuar në vitin 2011). Meqenëse këto dokumente kurrikulare ndryshojnë dhe përmirësohen vazhdimisht, drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale duhet të bëjnë kujdes që të **verifikojnë dy numrat e fundit** dhe të përzgjedhin e përdorin versionet më të përmirësuara.

- Drejtuesit dhe stafi i shkollave profesionale, para se të bëjnë përzgjedhjen e drejtimeve/profileve profesionale të reja që do të hapin në shkollat e tyre, duhet të konsultohen me Listën e përditësuar të Skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale (**Aneksi 1**) që ofrohen në Arsimin Profesional në vitin shkollor përkatës, ku edhe evidentohen skeletkurrikulat e reja dhe ato të përmirësuara. Shpjegime më të hollësishme për ndryshimet që janë bërë në skeletkurrikulat e përmirësuara jepen në **Aneksin 2**.

- Mësuesit e lëndëve teorike dhe moduleve praktike profesionale duhet që të njihen me të gjithë skeletkurrikulin në tërësi, si dhe me rubrikat përkatëse, dhe

jo vetëm me lëndën ose modulën që do të trajtojnë. Rekomandohet që ata të studjojnë edhe dokumentet e përshkrimeve të profesionit dhe të kualifikimit përkatës.

- Janë dy lëndë profesionale (“Bazat e Sipërmarrjes” kl.12 dhe kl.13 dhe “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” kl.13) që janë të përbashkëta për të gjitha drejtimet/profimet e arsimit profesional. Për këto lëndë, AKAFPK ka ofruar edhe programet e detajuara (analitike) dhe materiale të tjera, në mbështetje të mësuesve që i trajtojnë ato.

- Për të ndihmuar përmirësimin e skeletkurrikulave, lëndëve ose moduleve të veçanta, rekomandohet që drejtuesit dhe mësuesit të identifikojnë problemet më tipike gjatë zbatimit të tyre dhe të përgatisin **propozime të argumentuara** për ndryshime në to. Për këto propozime mund të kontaktojnë specialistët e Sektorit të Skeletkurrikulave në AKAFPK ose mund t'i dërgojnë në adresën Alqi.Mustafai@akafp.gov.al, çdo vit deri në fund të Majit.

Gjithashtu, për të ndihmuar në përmirësimin e programeve orientuese për provimet përfundimtare të çdo niveli, rekomandohet që propozimet e argumentuara për ndryshime të dërgohen pranë Sektorit të Vlerësim-certifikimit të nxënësve në AKAFPK, në adresën Lindita.Dhima@akafp.gov.al çdo vit deri në fund të Janarit.

ANEKSI 1

Lista e kualifikimeve profesionale dhe skeletkurrikulave përkatëse që ofrohen në AP në vitin shkollor 2016-17

Shënim:

- **SKELETKURRIKULAT E REJA** (futen për herë të parë në vitin shkollor 2016-17) tregohen me tekst me shkronja të mëdha dhe hijezohen me ngjyrë të gjelbër.
- **Skeletkurrikulat e rishikuara** për vitin shkollor 2016-17 tregohen me tekst me shkronja të pjerrëta dhe hijezohen me ngjyrë të kaltër.

STRUKTURA 2+1+1 vite mësimore				
NR	DREJTIMI MESIMOR Niv.I (2 vjeçar-kl.10-11)	PROFILI MESIMOR Niv.II (1 vjeçar-kl.12)	NR	DREJTIMI MESIMOR Niv.III (1 vjeçar-kl.13)
1	Hoteleri-turizëm	1.Reception	1	Hoteleri-turizëm
		2.Bar-restorant		
		3.Kuzhinë-pastiçeri		
		4.Guida turistike		
		5. KUZHINE-PASTIÇERI (pilot-Erasmus+)		
		6. RECEPSION (pilot-Erasmus+)		
2	Shërbime mjetesh transporti	1.Shërbime motorike	2	Shërbime mjetesh transporti
		2.Shërbime xhenerike		
		3.Shërbime elektroauto		
		4. Shërbime karrocerie		
3	Mekanikë	1.Makina metalpunuese		

4	Mekanik i kombinuar (pilot-PEM)	2.Konstruksione metalike 3.Mirëmbajtje dhe riparime mekanike 4. Metalurgji dhe fonderi	3	Mekanikë		
5	Elektroteknikë	1.Instalime elektrike civile dhe industriale	4	Elektroteknikë		
6	Elektroteknik i kombinuar (pilot-PEM)	2.Instalim dhe mirëmbajtje e TU dhe TL 3.Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake 4.Elektromekanik 5.Teknologji automatizimi (pilot - PEM)				
7	Elektronikë	1.Telekomunikacion 2.Riparime të pajisjeve elektronike			5	Elektronikë
8	Përpunim druri.	1.Prodhime druri gjysëm të gatshme			6	Përpunim druri
9	Përpunim druri (pilot-PEM).	2.Mobileri dhe tapiceri				
10	Përpunim druri i kombinuar (pilot-PEM).					
11	Ndërtim	1.Shtrim dhe veshje me pllaka 2.Karpenteri, hekurkthim dhe betonim 3.Muratim dhe suvatim 4.Punime dhe riparim rrugësh 5. PUNIME DEKORATIVE DHE BOJATISJE	7	Ndërtim		
12	Tekstil-konfeksione	1.Rrobaqepësi	8	Tekstil-konfeksione		
13	Konfeksione (pilot-PEM)	2.Tekstil				
14	Konfeksione (pilot-NABER-ADA)	3.MODELIM				
15	Teknologji ushqimore	1.Teknologji e perpunimit të qumështit 2. Teknologji e përpunimit të brumërave 3.Teknologji e prodhimit të pijeve alkoolike 4. Teknologji e përpunimit të mishit dhe peshkut.	9	Teknologji ushqimore		

		5. Teknologji e përpunimit të frutave dhe perimeve		
16	Bujqësi	1.Ferma bujqësore e blegtorale	10	Bujqësi
		2.Frutikulturë		
		3.Rritje e kafshëve e shpendëve		
		4.Mekanikë bujqësore		
		5. Kopshtari.		
		6.Prodhim shtazor (shk. Bushat)		
		7.Akuakulturë		
		8.Prodhim bimor		
17	Shërbime sociale dhe shëndetësore	1.Shërbime kujdesi për të moshuar.	11	Shërbime sociale dhe shëndetësore
		2.Shërbime kujdesi për fëmijë		
18	Instalues i sistemeve termohidraulike (pilot-AlbVET)	1.Instalues i sistemeve termohidraulike (pilot-AlbVET)	12	Instalues i sistemeve termohidraulike (pilot-AlbVET)
19	Teknologji kimike	1.Teknologji e përpunimit të naftës	13	TEKNOLOGJI KIMIKE
		2. TEKNOLOGJI E PRODHIMIT TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT		
20	Peshkim	1.PESHKIM		
21	Gjeologji miniera	1.MINIERA		
22	Detari			
23	Poligrafi			

STRUKTURA 2+2 vite mësimore		
NR	DREJTIMI MESIMOR Niv.I (2 vjeçar-kl.10-11)	PROFILI MESIMOR Niv.II-III (2 vjeçar-kl.12-13)
1	Ekonomi - biznes	1.Llogari
		2.Shërbime bankare
		3.Sipërmarrje e agejcsisë turistike
		4. Sigurime
		5.TREGTI
2	Ekonomi biznes/Administrim zyre (pilot-PEM) (nuk aplikohet)	1.Administrim biznesi (pilot-PEM) (vetëm për klasat në vijim)
3	Teknologji informacioni dhe	1.Rrjete të dhënash

	komunikimi (TIK)	2.Mbështetje e përdoruesve të TIK 3.Zhvillim website 4. RRJETE TE DHENASH (Pilot-GIZ)
4	Teknologji informacioni dhe komunikimi (pilot-PEM) (nuk aplikohet)	1.Elektronik në teknologjinë e automatizimit (pilot-PEM) (vetëm për klasat në vijim)
5	Pyje	1.Silvikulturë 2.Shfrytëzim pyjesh 3.Florikulturë
6	Ekonomi bujqësore (nuk aplikohet)	1.Agrobiznes (vetëm për klasat në vijim)

STRUKTURA bllok 4 vite mësimore	
NR	DREJTIMI MESIMOR Niv.I-II-III (4 vjeçar-kl.10-11-12-13)
1	Veterinari
2	Gjeodezi
3	SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR (PILOT-GIZ)

STRUKTURA 1 ose 2 vite mësimore	
NR	PROFILI MESIMOR Niv.IV (Pas të mesëm)
1	Diagnostikim-menaxhim në autoservis
2	Laborant ushqimor
3	Dizenjim mode
4	Instruktur në AFP
5	Kontroll laboratorik i ushqimit
6	Shërbime detare në kuvertë

në fushën e hartimit të përshkrimeve të kualifikimeve profesional

ANEKSI 2

Shpjegime dhe udhëzime për Skeletkurrikulat e reja dhe të rishikuara në vitin shkollor 2016-17

Skeletkurrikulat e reja:

1. Për drejtimin “Shërbime kujdesi për të moshuar-pilot GIZ”, niv.III”.
2. Për drejtimin “Teknologji kimike”, niv.III”.
3. Për profilin “Rrjete të dhënash-pilot GIZ”, niv.III”, në drejtimin “TIK”.
4. Për profilin “Reception-pilot Erasmus”, niv II”, në drejtimin “Hoteleri - turizëm”.

5. Për profilin “Kuzhinë pastiçeri-pilot Erasmus”, niv II”, në drejtimin “Hoteleri - turizëm”.
6. Për profilin “Modelim”, niv. II, në drejtimin “Tekstil konfeksione”.
7. Për profilin “Teknologji e prodhimit të materialeve të ndërtimit”, niv. II, në drejtimin “Teknologji kimike”.
8. Për profilin “Miniera”, niv. II, në drejtimin “Gjeologji miniera”.
9. Për profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niv. II, në drejtimin “Ndërtim”.
10. Për profilin “Peshkim”, niv. II, në drejtimin “Peshkim”.
11. Për profilin “Tregti”, niv. III, në drejtimin “Ekonomi biznes”.

Skeletkurrikulat e rishikuara:

1. Për drejtimin “Veterinari”, niv. III (zbatohet vetëm kl.10 për 2016-17).
2. Për drejtimin “Teknologji ushqimore”, niv. I (zbatohet vetëm kl.10 për 2016-17).
3. Për profilin “Teknologji e përpunimit të brumrave”, niv. II, në drejtimin “Teknologji ushqimore”.

Ndryshimet kryesore të bëra në skeletkurrikulat e rishikuara:

1. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Veterinari”, niv. III (kl.10-13).

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Të ushqyerit e kafshëve bujqësore” kl.10 dhe kl. 11, bëhet “Mbarështim i kafshëve bujqësore”. Pra kjo lëndë NUK ka ndryshime përmbajtësore”, vetëm ndryshim titulli;
- Lënda “Bazat e sipërmarrjes”kl.13 bëhet 32 orë gjithsej.
- Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” kl.13 bëhet 32 orë gjithsej.
- Lënda “Propiodeutikë” kl.13 bëhet 64 orë gjithsej .
- Lënda “Riprodhimi i kafshëve” kl.13 bëhet 32 orë gjithsej.
- Lënda “Parazitologji” kl.13 bëhet 64 orë gjithsej.
- Lënda “Kontroll blegtoral” kl.13 bëhet 32 orë gjithsej.

Te modulet e detyruara:

- Moduli 2 “Kujdesi për higjienën e kafshëve” kl. 10 është rishikuar.
- Moduli 7 “Përdorimi i veglave të thjeshta kirurgjikale” kl.11 është i rishikuar.
- Moduli 10 “Mjekimi i plagëve të ndryshme te kafshët” kl.11 është i rishikuar.
- Moduli 13 “Diagnostikimi i helmintozave në kafshët e gjalla dhe të therura” kl.12 është i rishikuar.
- Moduli 14 “Përgatitja e formave të ndryshme farmaceutike” kl.12, nga 90 orë bëhet 72 orë.
- Moduli 15 “Vaksinimi i kafshëve dhe shpendëve për sëmundjet infektive” kl.12, nga 72 orë bëhet 90 orë gjithsej.
- Modulet e detyruara të kl.13 (4 module) nga 51 orë bëhen 48 orë.

Te modulet me zgjedhje të detyruar:

- Modulet me zgjedhje të detyruar për kl.13 (2 module) nga 68 bëhen 64 orë.

2. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Teknologji ushqimore”, niv. I (kl.10-11).

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Vizatim teknik” (Kl 10), nga 2 orë në javë është bërë 1 orë në javë dhe ka ndryshime brendia
- Lënda “Higjienë dhe mbrojtje mjedisi”, nga një lëndë që zhvillohej në dy vite (kl.10-11) respektivisht me nga 1orë/javë, është bashkuar dhe do të zhvillohet vetëm në kl.10 me 2 orë/javë.
- Lëndët “Kimi inorganike”, “Kimi analitike dhe ushqimore” dhe “Procese, aparate dhe pajisje të teknologjisë ushqimore” kanë ndryshime përmbajtësore.

Te modulet e detyruara:

- Të gjitha modulet e detyruara, me titujt e tyre të pandryshuar, kanë ndryshime përmbajtësore

Te modulet me zgjedhje të detyruar:

- Moduli “Procese përgatitore për kryerjen e veprimtarive bazë të kontrollit të produkteve ushqimore në laborator”, kl.11, është modul i ri.
- Moduli “Procese përgatitore për përpunimin e ullirit për prodhimin e vajit dhe për konservim”, kl.11 ka përmbajtje të re, në titull dhe në përmbajtje (konservimi i ullirit)
- Të gjitha modulet e tjera, me titujt e tyre të pandryshuar, kanë ndryshime përmbajtësore.

3. Te skeletkurrikuli i profilit “Teknologji e përpunimit të brumrave”, niv II (kl.12)

Te modulet e detyruara:

- Moduli “Prodhimi i bukës masive” ka ndryshuar kohëzgjatja nga 102 orë është bërë 69 orë.
- Moduli “Prodhimi i asortimenteve me miell gruri dhe shtesa” ka ndryshuar kohëzgjatje, ka qënë 102 orë, është bërë 66 orë
- Moduli “Prodhimi i asortimenteve të ëmbla me miell gruri”, ka qënë 102 orë, është bërë 69 orë.
- Moduli “Prodhimi i biskotave” ka qënë modul me zgjedhje të detyruar, kalon në modul i detyruar dhe nga 51 orë është bërë 66 orë
- Moduli “Prodhimi i makaronave” ka qënë modul me zgjedhje të detyruar, kalon në modul i detyruar dhe nga 51 orë është bërë 69 orë
- Moduli “Pasticeria e furrës” është modul i ri.
- Moduli “Prodhimi i miellit” ka kaluar modul me zgjedhje të detyruar.
- Modul “Prodhimi i bukës me miell misri ,thekre, soje dhe miellra të harmonizuar” ka kaluar modul me zgjedhje të detyruar.



ANEKSI 4

Formati i “programit të mësimdhënies së moduleve praktike profesionale”

Shkolla Profesionale - Tiranë

Viti shkollor 2016-2017

Drejtimi/Profili profesional, Niveli I

Mësuesi:

Programi i mësimdhënies i Modulit Profesional: (Kodi.....)

Klasa 10 - 24 orë mësimore

Nr	Rezultatet mësimore/Koha	Veprimtaritë mësimore	Koha	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin
1		-				
		-				
		-				
2						
3						



Rruga: Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë

Web site: akafp.gov.al

Tel/fax.+355 4 2230497